

 REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova - Government of Kosovo Ministria e Kulturës / Rina dhe sportit / Министерство Кulture, Омодине / Sporta Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. Nr.	60 / 2016
Data Datum Date	11.01.2016
nënshkrimi Eprez. Signature	<i>Adona Shyti</i>
PRISHTINË, PRISTINA/PRISHTINA	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**  
**Ministarstvo Kulture, Omladina i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport**



**Komuna e Presheves – Opštine Preševa**

**MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT**

**I LIDHUR**

**NDËRMJET**

**MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

**DHE**

**KOMUNËS SË PRESHEVËS**

## **1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT**

Ky Memorandum lidhet më qëllim të përkrahjes financiare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për Komunën e Preshevës, respektivisht, aktiviteteve të cilat realizohen në kuadër të Shtëpisë së Kulturës “A. Krashnica” në Preshevë.

## **2. AUTORITETET**

Qëllim i Memorandumit do të përmbushet nga:

- 2.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / MKRS dhe
- 2.2. Komuna e Preshevës.

( në tekstin e mëtejshëm: Palët ).

## **3. OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i kryen obligimet si në vijim :

- 3.1. Zotohet për mbështetje financiare në funksion të realizimit të aktiviteteve në fushën e teatrit.
- 3.2. Zotohet për mbështetje financiare në funksion të realizimit të aktiviteteve në fushën e arteve skenike dhe pamore.
- 3.3. Zotohet për mbështetje financiare në funksion të realizimit të aktiviteteve në fushën e artit muzikor.
- 3.4. Zotohet për mbështetje financiare në funksion të realizimit të aktiviteteve nga fusha e letërsisë dhe bibliotekarisë.

## **4. OBLIGIMET E KOMUNËS SË PRESHEVËS**

- 4.1. Pranon mbështetjen financiare në funksion të realizimit të aktiviteteve të parapara në nenin 3 të këtij memorandumi.

- 4.2. Komuna e Preshevës, obligohet që pas përfundimit të aktiviteteve të mbështetura si në nenin 3 të kujdeset për saktësinë e të dhënave në fatura dhe pranimit me nënshkrim të shpenzimeve të krijuara për dhe rreth aktiviteteve të sipërpërmendura.

## **5. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SË MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E PAPANASHIKUARA**

- 5.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve;
- 5.2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të fakteve të paplanifikuara, anulimit të paplanifikuar të aktiviteteve të mbështetura, Fuqisë mbinatyrore/ Vis maior dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim më palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

## **6. AMANDAMENTIMI**

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshojë apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë Memorandum Bashkëpunimi, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në Memorandum Bashkëpunimi në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MiB-i, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

## **7. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRVESHJEVE**

Çdo mosmarrëveshje apo moskuptim eventual, Palët do të përpiqen që t'i zgjidhin me bisedime dhe mirëkuptim.

## **8. KOPJET DHE GJUHA E MEMORANDUMIT**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy ( 2 ) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

## 9. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

### PALET NËNSHKRUESE


Veton FIRZI,

Sekretar i Përgjithshëm  
Ministria e Kulturës, Rinisë,  
dhe Sporteve/MKRS


Ragmi MUSTAFA,

Kryetar i Komunës së Preshevës


Nënshkruar më 08/01.2016  
Prishtinë